



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 300/2 prot

Datë 08.02.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E**  
**OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT**  
**NGRIHEN PRETENDIME**

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-93011-01-11-2024, me objekt: “*Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 7,137,795 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 23.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

**Ankimues:**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK, me NIPT (J61827062E) & “Montal” SHPK me NIPT (J62009007F), Bulevardi “Zhan D’Ark”, Pallati Nr.53, Ap.6B, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, me adresë: Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë

**Subjekte të Interesuara:**

Operatori ekonomik “Trimed” SHPK, me NIPT (K51612031J), me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10, Godine 3 Katëshe, Kashar, Tiranë

Në datën 07.02.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokolli 300 datë 07.02.2024 e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-93011-01-11-2024, me objekt: “*Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 7,137,795 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 23.01.2024 nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, ku parashikohet se: “*Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.*”

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK me anë të ankesës me nr. protokolli 300/2024 datë 07.02.2024, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht, në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, të kriterëve si më poshtë:

[...]

**2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimin te cilesise per pajisjet mjeksore”, /ose ekuivalent/, të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

**Për rrjedhim të sa më lart, për rastet kur OE nuk është prodhues, AK kërkon një vetëdeklarim nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK kërkon paraqitjen e certifikatës në fjalë**

**2.3.4** Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për, tregëtim të materialeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ,Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre të përkthyer dhe të noterizuar.

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës

**2.3.8** Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT)

**2.3.9** Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Gjirokaster, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « **Materiale mjekimi të pergjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)**» dhe jo para datës **23.01.2024 ora 11 :00.**

1. - Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
2. - Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).
3. - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

## **Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh

kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përkrahjet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

**Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore**

<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>
<b>Nr</b>	<b>Artikulli</b>	<b>Specifikime</b>
	<b>Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme</b>	
2	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20
3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2
4	Bende allcie 10cm x 2.7m	Paketimi individual plastik
5	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitesë e mbrojtur me leter te shqiteshme
6	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20
7	Bende allcie 15cm x 2.7m	Paketimi individual plastik
9	Bende me parafine 10x10cm	Sterile, jo me shume se 10 cope per pako
10	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako
11	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako
13	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako

14	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 16pala; paketim individual (1 cope/pako)
17	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm <sup>2</sup> , me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm <sup>2</sup> fibrile kolagjeni ose ekuivalent
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako
19	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20
20	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .
21	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g
23	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu
24	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padepertueshme mendafshi, me ngjites antialergjik
25	Vaj instrumentash	Vaj per mbrojtjen e endoskopeve dhe instrumentave kirurgjikale qe kane pjese te levizshme. Perdoret pas pastrimit dhe para procesit te sterilizimit. Shishe max. 50-100ml ose ekuivalent
	<b>Sisteme dhe doreza</b>	
27	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishesh edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer lock + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP floë rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .
28	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.
29	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5
30	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24
	<b>Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion</b>	

31	<i>Filter baktericid</i>	<i>per respirim artificial, antibakterial, HMEF</i>
32	<i>Qarqe respiratori</i>	<i>per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm</i>
33	<i>Absorbues CO2 per Anestezi</i>	<i>Permbajtja: Hidroxiid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.</i>
36	<i>Sonde oksigjeni adult</i>	<i>nazale, adult, L=1.5-2 m</i>
39	<i>Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m</i>	<i>maske me rezervuar per medikamente</i>
41	<i>Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22</i>	<i>Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)</i>
43	<i>Dren silikoni</i>	<i>Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X</i>
47	<i>Dren torakal I drejte dhe anguluar</i>	<i>PVC, Ch16-Ch32</i>
48	<i>Dren abdominal double drain me katere te brendshem</i>	
51	<i>Set steril per funksionim vezike urinare</i>	<i>I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem</i>
59	<i>Lageshtues per CPAP</i>	<i>Me tub konektor</i>
71	<i>Set epidural</i>	<i>kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+ shiringe</i>
73	<i>Kateter arterial</i>	<i>20G-22G Seldinger</i>
76	<i>Urinokol pediatrik</i>	
77	<i>Kapese kordoni umbilikal</i>	
79	<i>Tub ushqimi pediatrik</i>	<i>Ch 4, 5. Pediatrik, neonatal. Pa latex/DEHP.</i>
80	<i>Zhgute</i>	
81	<i>Tuba endotrakeale pediatrike</i>	<i>ID 2 - 5mm, nazal/oral</i>
82	<i>Tuba endotrakeale adult</i>	<i>ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon</i>
83	<i>Kateter aspirimi pediatrik</i>	<i>Ch 8, 10</i>
84	<i>Kateter aspirimi adult</i>	<i>Ch 12, 14, 16, 18.</i>
85	<i>Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi</i>	<i>Ch 8, 10</i>

86	<i>Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi</i>	<i>Ch 12, 14, 16, 18.</i>
89	<i>Tub endotrakeal 7.5</i>	<i>ID 7.5 mm, nazo-oral, me ballon</i>
90	<i>Tub endotrakeal 8.0</i>	<i>ID 8.0mm, nazo-oral, me ballon</i>
91	<i>Maske Laringeale PVC</i>	<i>Maske PVC me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5</i>
92	<i>Maske Laringeale Silikon</i>	<i>Maske Silikon me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5</i>
96	<i>Spekulum vaginal</i>	<i>Steril, nje perdorimesh.</i>
97	<i>Set punkcioni pleural</i>	<i>Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.</i>
	<b><i>Materiale konsumi per monitorim diagnostike</i></b>	
102	<i>Leter printeri ECHO</i>	
105	<i>1-3 kanale</i>	
106	<i>3-kanale</i>	
107	<i>6-12 kanale</i>	
110	<i>Xhel per ECHO</i>	<i>Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona</i>
111	<i>Xhel per EKG</i>	<i>Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona</i>
112	<i>Elektroda monitorimi EKG</i>	<i>Elektroda monitorimi njepedorimeshe</i>
115	<i>Aparat tensioni</i>	<i>Me manometer</i>
116	<i>Steto-fonendoskop</i>	<i>Koke e sheshte</i>
118	<i>Termometer</i>	<i>termometer pacienti</i>
119	<i>Spatula ( druri )</i>	<i>Sterile, e paketuar individualisht</i>
121	<i>Set per identifikimin e nenes dhe femijes</i>	<i>Me dy pjese per doren e nenes dhe doren e femijes ne ngjyra te dallueshme</i>
122	<i>Gojez spirometrike</i>	
123	<i>Filter spirometrik antibakterial</i>	
124	<i>Set Filter spirometrik antibakterial</i>	<i>Set i perbere nga: filter antibakterial, gojez spirometrike, dhe klipi nasal</i>

140	Sisteme Transfuzioni Gjaku	
-----	----------------------------	--

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

*Materialet e mjekimit duhet të përmbushin standartet CE. Ato duhet të jenë të markuara CE në momentin e lëvrimit të mallit.*

*Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.*

*Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh.*

*Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës.*

*Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bërë në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi*

***Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara për çdo artikull.***

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 08.02.2024.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Fiorent Zguro**

**Anëtar  
Kreshnik Ternova**

**Kryetar  
Jonaid Myzyri**